

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP ‘....’ nga F., kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit doganor nr..... datë, lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr.349/2017 datë 06.12.2017, në seancën e mbajtur më 25.04.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit NTP ‘.....’, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.349/2017 dt. 06.12.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.349/2017 dt. 06.02.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit NTP ‘.....’, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep.administrativ, A-U nr. 784/15 datë 16.05.2017, me të cilin është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit e të paditurës-Doganës së Kosovës, datë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr..... dt....., të lëshuar nga Drejtoria Rajonale në F., kur paditësi është shpalluar përgjegjës edhe për kundërvajtje doganore dhe është denuar me gjobë prej 2.500,-Euro

Paditësi i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.349/2017 dt.06.12.2017, duke theksuar se ky aktgjykim është marrë me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të dispozitave të së drejtës materiale. Ka propozuar që të aprovohet kërkesa, të anulohen aktgjykimet e kontestuar, ai i Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr. 349/2017 dt. 06.02.2017, dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep.administrativ A.U.nr.784/15 dt. 16.05.2017.

Gjykata Supreme mbajti seancën në përputhje me nenin 53 të LKA, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.349/2017 dt. 06.12.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit NTP '.....', paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep. administrativ A.U.nr.784/15 dt.16.05.2017 me të cilin është refuzuar kërkespadija e paditësit për anulim të vendimit të të paditurës - Dogana e Kosovës nr..... dt..... për rishqyrtimin e aktvendimit nr..... dt....., të lëshuar nga Drejtoria Rajonale në F., kur paditësi është shpallur përgjegjës edhe për kundërvajtje doganore dhe është dënuar me gjobë prej 2.500,- Euro.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Supreme vlerëson si të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së dytë me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, pasi që aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore siç pretendon paditësi.

Gjykatat e instancave më të ulëta, nga provat materiale të shqyrtuara edhe në procedurën administrative, kanë konstatuar se paditësi ka bërë shkelje në raport me përmbushjen e obligimeve doganore konform autorizimit për drejtimin e një depoje doganore, duke lëshuar mallin në qarkullim të lirë pa njoftuar Doganën dhe pa i kryer obligimet doganore, prandaj nuk janë marrë si të bazuara pretendimet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka aplikuar edhe dispozitat ligjore. Në padinë e tij paditësi e pranon faktin se një pjesë të vogël e sasisë të mallit është nxjerrë nga depoja doganore, që e ka vendosur për shitje të mëtutjeshme, mirëpo nga lista e fletëshkarkimeve të mallit dhe fletëdërgesës nr..... dt..... që gjenden në lëndë, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk kanë mundur të vlerësojnë se kjo sasi e mallit është dalur në qarkullim të lirë, sepse nuk ekzistojnë provat materiale që dëshmojnë se paditësi ka njoftuar Doganën për këto shkarkime të kryera me kohë sipas kushteve të përcaktuara me autorizim, dhe nuk ka paraqit prova se këtë sasi të mallit e ka regjistruar në librat dalëse nga depoja doganore.

Më tej, paditësi nuk ka dëshmuar me asnjë provë konkrete se malli lëndor kontestues ishte i pranishëm me rastin e vizitës nga kontrolli me datë dhe nuk i ka paraqit gjykatës se cilat regjistra-evidenca ia ka paraqit kontrollit se malli kontestues ka pasur dalje nga depoja doganore. Për këtë arsye nuk janë marrë si të bazuara pretendimet e paditësit se gjykatat gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht kanë aplikuar dispozitat ligjore.

Në rastin konkret, paditësi nuk ka vepruar sipas kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me autorizimet e Doganës, prandaj kjo Gjykatë konstaton se e paditura ka aplikuar drejtë ligjin kur paditësin e ka bërë përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 276 paragrafi (v) të Kodit Doganor (03/L-109), dhe i ka shqiptuar gjobën administrative. Andaj, kjo Gjykatë konkludon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejtë kanë aplikuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe

Procedurat nr.03/L-222, të Kodit Doganor nr.03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-099.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pohimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara sepse ato nuk ndikojnë në vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet vendimtare. Gjykata Supreme vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 54 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
ARJ-UZVP nr. 31/2018 datë 25.04.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Nebojsa Boriçiq

Përktheu,
F. A.